VENDIM
Nr. 56, datë 3.4.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR TRANSPOZIMIN E RREGULLORES 2017/459, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 2018/06/PHGL-ENC, "MBI THEMELIMIN E KODIT TE RRJETIT PËR MEKANIZMAT E ALOKIMIT TË KAPACITETEVE NË SISTEMET E TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR"

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, dhe neneve 16 dhe 44, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar, parashikimeve të vendimit nr. 2018/06/PHGL-EnC, datë 28.11.2018, të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë, si dhe nenit 26 të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e datës 3.4.2019, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike mbi fillimin e procedurës për transpozimin e rregullores 2017/459 të miratuar me vendimin nr. 2018/06/PHGL-EnC, "Mbi themelimin e kodit të rrjetit për mekanizmat e alokimit të kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit natyror",

Konstatoi se:

- Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror "ALBGAZ" sh.a., me shkresën nr. 18 prot., datë 18.2.2019, ka paraqitur për shqyrtim dhe miratim në ERE "Kodin e Rrjetit për mekanizmat e ndarjes së kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit natyror", të përditësuar dhe të përkthyer në gjuhën shqipe.
- Bazuar në autoritetin që i është dhënë dhe në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar, ERE ka kompetencën të miratojë "Kodin e rrjetit për mekanizmat e alokimit të kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit natyror".
- Ky Kod do të shqyrtohet dhe miratohet si detyrim i sa më poshtë:
- Shqipëria është anëtare e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë që nga data 1.7.2006.
- Parashikimet e Rregullores (të BE-së) nr. 715/2009, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropës.
- Kërkesat e Rregullores së Komisionit (KE) 2017/459, të datës 16 mars 2017.
- Vendimit nr. 2018/06/ PHGL-EnC, datë 28.11.2018, të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë.
- Parashikimeve të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar.
- Licencimin e shoqërisë "ALBGAZ" sh.a. në aktivitetin e Transmetimit të Gazit Natyror.
- Licencimin shoqërisë "ALBGAZ" sh.a. në aktivitetin e Shpërndarjes së Gazit Natyror.
- Certifikimin paraprak të Operatorit të Kombinuar të gazit natyror "ALBGAZ" sh.a. në përputhje me nenet 37, 50, 59, 68, dhe 80 të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar, dhe nenin 9, pika 6, të Direktivës 73/2009 EC.
- ALBGAZ sh.a. gëzon statusin e vëzhguesit pranë ENTSO-G, Rrjetit Europian të Operatorëve të Transmetimit të Gazit Natyror.
- Ky Kod është hartuar dhe përshtatur në respektim të parashikimeve të dispozitave të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar, si dhe parashikimeve të vendimit nr. 2018/06/ PHGL-EnC, datë 28.11.2018, të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë, duke dhënë orientim në lidhje me mekanizmat e alokimit të kapaciteteve në sistemet e trasmetimit të gazit natyror.
- Në referencë të vendimeve të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë PHLG-ENC, kjo rregullore do të bëhet e detyrueshme për të gjithë pjesëmarrësit e tregut. Transpozimi do të bëhet pa

ndryshime në strukturën e tekstit të Rregullores (EU) nr. 2017/460, përveç përkthimit dhe përshtatjes të bërë sipas këtij vendimi.

- Në kontekst të zbatimit të përgjegjësive të monitorimit të zbatimit, Sekretariati do të monitorojë dhe analizojë, se si operatorët e sistemit të transmetimit, kanë zbatuar këtë Rregullore:

1. Operatorët e sistemit të transmetimit duhet t'i dorëzojnë Sekretariatit të Komunitetit të energjisë, të gjitha informacionet e kërkuara nga Sekretariati për të përmbushur detyrimet e tij sipas paragrafit 1, jo më vonë se 9 muaj pas skadimit të afatit për transpozimin e kësaj Rregulloreje.

2. Konfidencialiteti i informacionit komercialisht të ndjeshëm ruhet nga Sekretariati.

3. Jo më vonë se dy vjet pas skadimit të afatit për transpozimin e kësaj rregulloreje, Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë do të raportojë mbi kushtet e parashikuara në kontratat për produkte të kapacitetit standard për kapacitetin e garantuar, duke pasur parasysh efektet e tyre në përdorimin efikas të rrjetit dhe integrimin e tregjeve të gazit të Komunitetit të Energjisë. Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë do të mbështetet në vlerësimin e tij nga Autoritetet Kombëtare Rregullatore dhe Operatorët e Sistemit të Transmetimit.

Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për transpozimin e Rregullores 2017/459, të miratuar me vendimin nr. 2018/06/PHGL-EnC, "Mbi themelimin e kodit të rrjetit për mekanizmat e alokimit të kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit natyror".

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim, brenda 7 ditëve nga data e marrjes së vendimit, në ERE dhe të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti